



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës  
Seanca nr.2003/5  
Prishtinë,më 27 shkurt 2003,ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi z.Nexhat Daci,kryetar i Kuvendit të Kosovës,kurse bashkëkryesus ishin:  
z.Gojko Saviq,në pjesën e parë,kurse në atë të dytë z.Bajram Kosumi,anëtarë të Kryesisë.  
Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 89 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Për këtë seancë u propozua ky

**REND DITE:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Procesverbali nga seanca e kaluar ;
3. Shqyrtimi i parë P/ligjit për Bibliotekat e Kosovës;
4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Lëndën Arkivore dhe Arkivat;
5. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së,për zëvendësimin e përkoshëm të anëtarit të Kryesisë së Kuvendit;
6. Parashtrimi i pyetjeve.

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

**Kryesuesi** kërkoi nga deputetët e Kuvendit që të miratohet propozimi i rendit të ditës.

Pas kësaj,**Berat Luzha** tha se Grupi Parlamentar i PDK-së dhe deputetët e grupeve tjera parlamentare,kanë bërë para disa ditësh një kërkesë për thirrjen e një seance të

jashtëzakonshme,në të cilën duhet të shqyrtohet rasti i ngritjes së aktpadisë nga ana e Gjykatës së Hagës,kundër kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së,Fatmir Limaj.Duke e konsideruar këtë rast si çështje urgjente,theksoi z.Luzha,kërkojmë që çështja Limaj të vëhet në pikën e parë të rendit të ditës të kësaj seance.

**Dragisha Krstoviq** tha se ka dy vërejtje serioze në punën e këtij Kuvendi:a) Nëntë deputetë të koalicionit “Kthimi” sot nuk kanë mundur të vijnë në këtë seancë,ngase atyre nuk i është siguruar transporti i nevojshëm,dhe b) Në këtë seancë po ngriten çështje që janë jashtë kompetencave të këtij Kuvendi dhe nëse ato sot debatohen,atëherë deputetët e koalicionit “Kthimi” nuk do të marrin pjesë në punën e kësaj seance.

**Kryesusi** tha se çështja e transportit për deputetët e koalicionit “Kthimi” është diskutuar edhe në Kryesinë e Kuvendit dhe është marrë qëndrim që të organizohet transporti i rregullt dhe dinjitoz për të gjithë deputetët njësoj.

**Bujar Dugolli** tha se Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së që çështja Limaj të vihet në rend të ditës në seancën e sotme.Para dy ditësh në Zveçan,disa deputetë të komunave që quhen “serbe” duke përfshirë edhe disa deputetë të këtij Kuvendi nga koalicioni “Kthimi”,kanë mbajtur një “Kuvend të komunave” dhe kanë miratuar një “deklaratë për ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit teritorial të Sebisë dhe të Malit të Zi mbi Kosovën”.Grupi Parlamentar i AAK-së e kundërshton një veprim të tillë,theksoi z.Dugolli dhe kërkoi që kjo çështje të vihet në rend të ditës të kësaj seance dhe Kuvendi i Kosovës të marrë qëndrim lidhur me këtë çështje.

**Lirak Çelaj** tha se për këtë seancë është paraparë shqyrtimi i P/ligjit për Bibliotekat.Para se të shqyrtohet ky P/ligj,duhet të sqarohet se në kompetencë të cilës ministri janë bibliotekat? Sipas Rregullorës 2001/19,shtojca e katërt,theksoi z.Çelaj,bibliotekat janë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit,Shkencës dhe të Teknologjisë,kurse P/ligjin e ka hartuar Ministria për Kulturë,Rini dhe Sport,që sipas tij, paraqet shkelje të ligjit.

**Dragisha Krstoviq** tha se për caktimin e rendit të ditës të kësaj séance,duhet të bëhet një pauzë që grupet parlamentare t’i harmonizojnë qëndrimet e tyre lidhur me këtë.

**Muhamed Kelmendi**,tha se përkrah kërkesat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të AAK-së që kërkesat e tyre të vihen në rend të ditës të kësaj séance.Shprehu shqetësimin e tij lidhur me burgosjen e të rinjve shqiptarë që bëhen nga autoritetet serbe dhe kërkoi që Kuvendi i Kosovës të nxjerrë një Rezolutë për Luginën e Preshevës,me të cilën përkrahen organet legjitime të atyre komunave dhe proceset demokratike të atij rajoni.

**Sabit Rrustemi** tha se çështjen që e shtroi z.Çelaj lidhur me bibliotekat,pavarsisht se si është rregulluar ajo me Rregulloretë të UNMIK-ut,ato duhet të jenë në kompetencë të Ministrisë së Kulturës,Rinisë,Sporteve dhe Çështjeve të Migracionit.

**Kryesusi** dha një orë pauzë,për konsultim të grupeve parlamentare lidhur me caktimin e rendit të ditës.

**Kryesuesi** kërkoi edhe mendimin e grupeve tjera parlamentare që nuk janë deklaruar lidhur me përcaktimin e rendit të ditës.

**Berat Luzha** tha se katër grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës, pas konsultimeve kanë dalur me një deklaratë të përbashkët lidhur me ngritjen e aktakuzës kundër z. Fatmir Limaj, deputet dhe kryetar u Grupit Parlamentar të PDK-së, e inicuar nga grupi Parlamentar i PDK-së dhe e përkrahur nga grupet parlamentare të LDK-së, AAK-së dhe të minoriteteve tjera, si vijon

## D E K L A R A T Ë

Kuvendi i Kosovës konfirmon përcaktimin për njohjen e juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish Jugosllavi dhe për bashkëpunim institucional të ndërsjelltë dhe të rregulluar me Ligj të Kosovës për këtë Gjykatë.

Kuvendi i Kosovës apelon te Gjykata Ndërkombëtare e Hagës që deputetin Fatmir Limaj, i cili ka shprehur me kohë dhe publikisht gatishmërinë për t'u paraqitur vullnetarisht në Hagë, të trajtohet si vetëparaqitur dhe t'i mundësohet mbrojtja në liri.

Kuvendi i Kosovës kundërshton përpjekjet për politizimin dhe etnicizimin e drejtësisë si dhe barazimin e qëndresës dhe luftës çlirimtare në Kosovë, me luftën shfarosëse kundër Kosovës dhe popullit të saj.

Deklaratën e kishin nënshkruar në emër të katër grupeve parlamentare: të LDK-së-Alush Gashi, të PDK-së-Berat Luzha, të AAK-së-Bujar Dugolli dhe të minoriteteve të tjera-Faik Marolli.

Derisa z. Luzha e paraqiti Deklaratën, deputetët e koalicionit "Kthimi" në shenjë paknaqësie e lëshuan seancën.

**Kryesuesi** e vëri në votim Deklaratën në fjalë. Rezultati ishte si vijon:

Për ----të gjithë të pranishmit;  
Kundër----- 0;  
Abstenime-----0.

**Kryesuesi** konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi deklaratën në fjalë.

Pastaj, **Bujar Dugolli** tha se katër grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës, me koncesus kanë hartuar këtë

## D E K L A R A T Ë

PËR SHPALLJE TË PAVLESHME TË FORMIMIT TË "BASHKËSISË SË KOMUNAVE" SERBE NË VERI TË KOSOVËS.

1. Krijimi i institucioneve paralele në Kosovë është në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese dhe me tërë procesin politik;

2. Krijimi i institucioneve njëetnike në Kosovë është në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese dhe me tërë procesin politik;
3. Çdo ndarje e territorit të Kosovës, e brendshme apo e jashtme, është në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese dhe si e tillë është e pavlefshme;
4. Çdo dokument i miratuar nga një institucion i tillë i paligjshëm është i pavlefshëm për Kuvendin e Kosovës dhe për institucionet tjera të pushtetit dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe
5. Apelojmë te UNMIK-u që të marrë masa të duhura kundër veprimeve të tilla antiligjore.

Deklaratën e kishin nënshkruar në emër të katër grupeve parlamentare: të LDK-së-Alush Gashi, të PDK-së-Berat Luzha, të AAK-së- Bujar Dugolli dhe të minoriteteve të tjera- Faik Marolli.

**Kryesuesi** e vuri në votim Deklaratën në fjalë dhe rezultati ishte si vijon:

Për- gjithë deputetët e pranishëm;  
 Kundër -----0;  
 Abstenime----- 0.

**Kryesuesi** konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi deklaratën në fjalë.

### **3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e përkohshëm të anëtarit të Kryesisë së Kuvendit.**

**Kryesuesi** tha se Grupi Parlamentar i LDK-së ka bërë kërkesë për zëvendësimin e përkohshëm të anëtarit të Kryesisë, z. Fatmir Sejdiu me z. Sabri Hamitin, deri sa të kthehet z. Sejdiu nga SHBA-të.

**Kryesuesi** e vuri në votim kërkesën në fjalë dhe rezultati ishte si vijon:

Për--- shumica e të pranishmëve;  
 Kundër ----- 0;  
 Abstenime-----3.

**Kryesuesi** konstatoi se anëtar i Kryesisë së Kuvendit përkohësisht u zgjodh z. Sabri Hamiti.

**Hydajet Hyseni** tha se një zëvendësim i tillë nuk është në përputhje me procedurat e Rregullorës së Punës të Kuvendit të Kosovës.

### **4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Bibliotekat e Kosovës dhe të atij për Lëndën Arkivore dhe Arkivat.**

**Kryesuesi** e ftoi ministrin e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe të Çështjeve Jorezidente që t'i arsyetonte dy Projektligjet në fjalë, pasi që ajo i kishte hartuar ato.

**Ministri Behxhet Brajshori** në fillim arsyetoi P/ligjin për Bibliotekat e Kosovës. Ai tha se këtë P/ligj e kanë hartuar ekspertët vendorë që kanë konsultuar përvojat, standartet dhe dokumentet e Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare dhe udhëzimeve të Këshilit të Evropës për legjislacion dhe politikën bibliotekare në Evropë.

Me këtë P/ligj ndahet funksioni i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare në dy institucione: në Bibliotekën Kombëtare dhe në Bibliotekën Univerzitare, e cila trajtohet si bibliotekë e përgjithshme shkencore.

Ky P/ligj është i avansuar, shtoi z. Brajshori sepse: a) Saktson dhe qartëson të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve të qeverisjes në nivel komunal dhe atë qendror lidhur me mbështetjen, mbikqyrjen administrative dhe financimin e bibliotekave të sektorit publik;

b) Saktson dhe garanton të drejtat e qytetarëve për shërbim bibliotekar në mënyrë të barabartë pa asnjë dallim diskriminues dhe kështu shpreh në tërësi standartet demokratike ndërkombëtare në këtë fushë; c) Fut detyrimin e çdo biblioteke për t'u regjistruar në regjistrin e bibliotekave; d) Sanksionon si kundërvajtje veprimet apo mosveprimet që janë në kundërshtim me mënyrën dhe kushtet e ushtrimit të veprimtarisë bibliotekare si dhe ato që cenojnë të drejtën e përdoruesve në shërbimin bibliotekar.

**Ministri Brajshori e arsyetoi edhe P/ ligjin për lëndën Arkivore dhe Arkivat.** Ai tha se nevoja për nxjerrjen e këtij ligji është për arsye se organizimi dhe veprimtaria e arkivave ballafaqohen me nevojën e transformimit dhe modernizimit, në përshtatje me realitetin e ri, me sfidat e reja të epokës elektronike dhe me standartet bashkëkohore të administrimit të informacionit dhe të dokumentacionit.

Ky P/ligj mbështetet në këto parime: Arkivat përbëjnë një pjesë thelbësore dhe të pazëvendësueshme të pasurisë kulturore; Sigurohet tërësia e dokumenteve të çfarëdo kohe, forma dhe bartësi material i tyre, të krijuara apo të marra nga çdo person fizik ose juridik në ushtrimin e aktivitetit të tij publik; Lënda arkivore mbrohet pa marrë parasysh në pronësi të kujt është; Shfrytëzimi i arkivave përbënë një të drejtë që u njihet të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga kombësia, statusi apo funksioni i tyre; Komunikimi i dokumenteve dhe mjeteve të kërkimit si pjesë përbërëse e shërbimit arkivor; Hapja pa kufizim i arkivave pas afatit të përgjithshëm të ruajtjes së dokumentit përkatës; Mjetet e kërkimit duhet të mbulojnë tërësinë e arkivave dhe janë lirish të konsultueshme; Mundësia për të këshilluar dhe përdorë dokumentet arkivore, përkatësisht e drejta e qasjes realizohet me rregullat e parashikuara me këtë P/ligj, me akte nënligjore dhe me rregulloren e arkivit përkatës.

Ekspozeu i Ministrit Brajshori në tërësi i është bashkangjitur transkriptit.

Ministri Brajshori i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratojnë këto dy P/ligje.

Në P/ligjin për Bibliotekat e Kosovës, opinionet, vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e veta i dhanë deputetët: **Exhlale Salihu, Blerim Baruti, Ramadan Kelmendi, Edi Shukriu, Mevlyde Saraqi, Sabit Rrustemi, Lirak Çelaj, Sanije Aliaj dhe Flora Brovina**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

**Kryesuesi** e vuri në votim P/ligjin për Bibliotekat e Kosovës dhe rezultati ishte si vijon:

Për: shumica e të pranishmëve;

Kundër:-----1;

Abstenime:-----0.

**Kryesuesi** konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për Bibliotekat e Kosovës.

Në P/ligjin për Lëndën Arkivore dhe Arkivat, opinionet, vërejtjet, propozimet, dhe sugjerimet e veta i dhanë deputetët: **Edi Shukriu, Sabile Keçmezi - Basha, Drita Statovci, Sebahate Grejëvci, Shefki Sejdiu, Alush Gashi, Ramadan Kelmendi, Gani Sadik dhe Berat Luzha, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.**

**Kryesuesi** e vuri në votim këtë P/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për: të gjithë të pranishmit;

Kundër: askush;

Abstenime: askush.

**Kryesuesi** konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për Lëndën Arkivore dhe Arkivat.

## **5. Parashtrimi i pyetjeve.**

Deputeti **Gani Sadik** i kishte parashtruar pyetje kryeministrit **Bajram Rexhepi** lidhur me gazetën “TAN”. Kryeministri i është përgjigjur me shkrim dhe ajo i është shpërndarë deputetve.

**Sabit Rrustemi** pyeti Kryesinë e Kuvendit pse ende nuk është formuar Komisioni për Media?

**Bujar Dugolli** pyeti Kryesinë e Kuvendit pse nuk e ka radhitur në rend të ditës për seancën plenare kërkesën e AAK-së për nxjerrjen e një rezolute për mbrojtjen e vlerave të Luftës Çlirimtare të popullit të Kosovës?

Seanca përfundoi në orrën 14:00.

**Sekretaria e Kuvendit**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,  
akademik **Nexhat Daci**